



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 112
Prishtinë, më 4 qershor 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 QERSHOR 2010**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 72 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e seancës.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Ratifikimi i Marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hetim parlamentar,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës,
10. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë: **Naim Rrustemi, Drita Maliqi, Ardian Gjini, Rexhep Hoti, Xhezair Murati, Riza Smaka, Zafir Berisha, Bujar Dugolli, Nait Hasani, Driton Tali, Enis Kervan, Ismet Beqiri, Naser Rugova** dhe zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi**, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Rexhep Hoti** parashtroi pyetje për ministrin e Ambientit, Mahir Yagcilar, lidhur me ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

Ministri **Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hoti.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** parashtroi pyetje për kryeministrin Thaçi lidhur me zgjedhjet lokale të organizuara nga Serbia në pjesën veriore të Mitrovicës.

Kryeministri Thaçi nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me çështjen e pensionistëve invalidorë të KEK-ut.

Ministri **Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputetja **Suzana Novoberdaliu** parashtroi pyetje për ministrin e Ambientit, Mahir Yagcilar, lidhur me nivelin e lartë të ndotjes së ambientit në Kosovë.

Ministri **Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetes Novobrdaliu.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me lansimin e projektit “Berza e punësimit Kosova 2010”.

Ministri **Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtroi pyetje për ministrin e financave, Ahmet Shala, lidhur me obligimet e Kosovës ndaj kreditorëve të huaj për kthimin e huave, si dhe çështjen e aseteve.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputetja **Mimoza Ahmetaj** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, lidhur me obligimet dhe përgjegjësitë që ka marrë Policia Kufitare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për kontrollin dhe ruajtjen e vijës kufitare Kosovë - Shqipëri.

Ministri **Rexhepi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Ahmetaj.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Blerand Stavileci, lidhur me politikat qeveritare për bujqësinë në vendin tonë.

Ministri **Stavileci** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministren e Administratës Publike, Edita Tahiri, lidhur me eliminimin e marrëdhënieve qiramarrëse qeveritare, me pronarët privat.

Ministrja **Tahiri** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin e punës.

Ministri **Nenad Rashiq** tha se procedimi i Projektligjit të punës në Kuvend paraqet një ngjarje me rëndësi, pasi që për këtë projektligj është folur mjaft shumë dhe ky është një rast i mirë që të gjitha informacionet rreth këtij projektligji t'i paraqes para jush.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i të drejtave dhe të detyrave nga marrëdhënia e punës, mënyra e krijimit të saj, kontrata kolektive, të gjitha këto në pajtim me konventat ndërkombëtare të punës dhe legjislacionin e BE-së, tha ai.

Në vazhdim, potencoi se dispozitat e projektligjit parashihet të vlejnjë për të punësuarin dhe punëdhënësin në sektorin publik dhe atë privat, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me ndonjë ligj të veçantë, por që dispozitat e këtij të fundit nuk parashohin zgjidhje për çështje të caktuara nga kjo fushë.

Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të këtij projektligji, pas miratimit të tij, parashihet të jetë në kompetencë të Inspektoratit të Punës, konstatoi ministri dhe i ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit të punës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit të punës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nurishahe Hulaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzan Novobrdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Emrush Xhemajli, Drita Maliqi, Shkumbin Demaliaj, Ismajl Kurteshi, Rexhep Hoti, Arsim Bajrami, Mimoza Ahmetaj, Sanije Aliaj, Driton Tali, Teuta Hadri, Naim Rustemi, Nerxhivane Dauti, Gani Buçinca, Hajdin Abazi, Ibrahim Gashi, Zylfije Hundozi dhe Nekibe Kelmendi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin e punës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë para deputetëve të Kuvendit që ta arsyetojë Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ministri **Fehmi Mujota** tha se sipas Ligjit, struktura e FSK-së përbëhet prej 2500 pjesëtarëve aktiv dhe komponentit rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili parashihet të ketë 800 pjesëtarë.

Ky projektligj është i paraparë në kuadër të Strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës, i cili përcakton: uniformën, aftësimin profesional, të drejtat dhe përgjegjësitë individuale dhe procedurat e mobilizimit në pjesën rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Më tutje, ministri tha se Ministria që ai udhëheq ka bërë të gjitha përgatitjet që pas miratimit të këtij ligji të fillohet me stërvitjen e komponentit rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kurse në fund i ftoi deputetët që ta miratojnë, në parim, këtë projektligj.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Avdiu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Drita Maliqi, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slllobodan Petroviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vladimir Todoroviq, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se miratimi i këtij projektligji është më se i nevojshëm për shkak se në ligjin ekzistues ka disa gjëra që nuk janë të përfshira.

Në vazhdim, ai tha se ky projektligj parasheh një infrastrukturë komplete dhe përmbajtësore për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe është i harmonizuar me direktivat evropiane nga kjo fushë. Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis ka 42 nene dhe 3 shtojca, tha ministri, kurse në fund i ftoi deputetët ta miratojnë, në parim, Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selville Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Sllobodan Petroviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vladimir Todoroviq, si dhe deputetja Gjylnaze Sylja, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----6,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rishqyrtimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Deputeti **Bajram Kosumi** tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka punuar për disa muaj me radhë për harmonizimin e neneve të këtij Ligji.

Në vazhdim, tha se ky ligj është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe potencoi vlerësimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa se implikimet buxhetore që rrjedhin pas miratimit të këtij ligji janë të përballueshme.

Në fund, ai ftoi deputetët ta miratojnë Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Deputeti **Sabri Hamiti**, i mbështetur edhe nga deputeti **Arsim Bajrami**, paraqiti një propozim lidhur me sigurimin shëndetësor.

Propozimin në fjalë Kuvendi nuk e miratoi.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 38.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,
Kundër-----2,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hetimin parlamentar

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë raportin e komisionit.

Pasi në emër të komisionit funksional dhe as nga deputetët nuk pati të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për hetimin parlamentar, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 10.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për hetimin parlamentar.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit raportin e komisionit.

Deputeti **Ramadan Gashi** tha se Komision funksional ka pasur dilema të neni 5 i Projektligjit, veçmas pas propozimit të Zyrës Civile Ndërkombëtare, dhe kemi rekomanduar që ky nen të mbetet me vetëm një paragraf, përkatësisht që paragrafi 2 dhe 3, i këtij neni të hiqen.

Pasi nga deputetët nuk pati të paraqitur për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 8.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,
Kundër-----1,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

10. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare

Kryesuesi konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës – Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare, është miratuar në mbledhjen e kaluar.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale